

VENDIM
Nr. 88, datë 9.6.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBANIAN GREEN ENERGY” SHPK, PËR
SHTYRJEN E AFATEVE TË LICENCËS NR. 63, SERIA NPM08P, PËR NDËRTIM,
INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALE EOLIKE (BLOK MOTORË-GJENERATORË TË USHQYER ME
BIOMASË TË LËNGSHME), TË DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s ME
NR. 89, DATË 6.8.2008, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 5 dhe 6, të rregullores “Për procedurat e heqjes së një licence”, neneve 16, pika 2 dhe 18 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar; pikave 1.2, 1.6 dhe 1.7 të kushteve të licencës nr. 63, seria NPM08P, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (blok motorë, gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.6.2016, mbasi shqyrtoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE në licencën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të burimeve të rinovueshme të energjisë ERE ka pranuar kërkesat e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., në lidhje me shtyrjen e afateve për realizimin e projektit, duke përfshirë këtu edhe kolaudimin e veprës.

- ERE ka miratuar shtyrjen e afateve me vendimet:

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 19, datë 8.3.2010;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 92, datë 6.9.2011;

- vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 138, datë 15.11.2013.

- Me shkresën me nr. 03/15 prot., datë 3.4.2015, shoqëria “Albanian Green Energy” sh.p.k, ka paraqitur një kërkesë tjetër për shtyrjen me 12 muaj të afateve të licencës së ndërtimit të dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar, së fundmi me vendimin nr. 138, datë 15.11.2013.

- Mospërmbushja e pikës 1, germa “d”, të vendimit nr. 89, datë 6.8.2008, i ndryshuar, e bën licencën të pavlefshme.

- Kur nuk përmbushen kushtet thelbësore të licencës së dhënë, sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE, me iniciativën e vet mund të heqë licencën.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të licencës nr. 63, seria NPM08P, për ndërtim, instalim, shfrytëzimin të centraleve elektrike dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale eolike (blok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme), Shëngjin Lezhë, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008.

2. Filimin e procedurave për heqjen e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., nr. 63, seria NPM08P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s me nr. 89, datë 6.8.2008.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti